



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Agjencia e Prokurimit Publik

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë  
e Informacionit të Klasifikuar

Nr. ~~54~~ Prot. Dt. ~~27.07~~ 2023

Nr. 242 Prot. Dt. 27.07 2023

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, (në vijim referuar si “Marrëveshja”) lidhet midis:

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK (në vijim “APP”)**, person juridik, publik e buxhetor në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Znj. Reida KASHTA**, që në vijim do t’i referohemi si “palë”,

**DHE**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (në vijim “AKSIK”)**, person juridik, publik e buxhetor në varësi të Kryeministrit, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga “Ibrahim Rugova”, 1019, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **Z. Dorian TOLA**, që në vijim do t’i referohemi si “palë”.

#### KUSHTET PARAPRAKE:

Duke qenë se të dyja palët janë institucione shtetërore në varësi të Kryeministrit;

Duke qenë se të dyja palët në përmbushje të funksioneve dhe detyrave institucionale, kryejnë veprimtari në fusha të përbashkëta, që lidhen me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”;

Duke qenë se, referuar nenit 14 dhe 58 të Ligj Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, APP është institucioni përgjegjës për verifikimin e zbatimit të procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit;

Duke qenë se, referuar nenit 62 të ligjit Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, AKSIK ka për mision organizimin, drejtimin e kontrollin e masave për ruajtjen, klasifikimin dhe administrimin e informacionit të klasifikuar;

Palët, duke vlerësuar se bashkëpunimi ndërmjet tyre i shërben mirëfunksionimit të veprimtarisë së tyre, për realizimin e detyrave përkatëse me shpejtësi, efikasitet dhe besueshmëri, nënshkruajnë këtë marrëveshje me kushtet e mëposhtme:

## **Neni 1 Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, VKM Nr. 867, datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, ligjin Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, VKM Nr. 542, datë 29.9.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, ligjin Nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, VKM Nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, si dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

## **Neni 2 Qëllimi**

1. Marrëveshja ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve në funksion të ndërgjegjësimit të autoriteteve kontraktore në mirëzbatimin e legjislacionit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për mirëzbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave.
2. Përcaktimet e marrëveshjes nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim, të të cilëve lidhet kjo marrëveshje.

## **Neni 3 Angazhimet e palëve**

Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshje dhe në mënyrë të veçantë:

- a. Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke informacion për çështje të veçanta, për të cilat institucionet kanë interes të përbashkët, në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara;
- b. Të shkëmbejnë në mënyrë reciproke akte, literaturë juridike, interpretime ligjore apo rregullatorë që kanë të bëjnë me prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe me informacionin e klasifikuar;
- c. Të organizojnë e marrin pjesë në takime të përbashkëta për përmirësimin e punës në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga legjislacioni përkatës;
- ç. Të organizojnë dhe të kryejnë trajnime të përbashkëta për autoritetet kontraktore që kryejnë prokurime në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, të cilat përmbajnë informacion të klasifikuar;

d. Të kryejnë monitorime të përbashkëta, me qëllim verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e autoriteteve kontraktore, gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, si përsa i përket zbatimit të rregullave të prokurimit, ashtu edhe zbatimin e rregullave, procedurave dhe kërkesave që lidhen me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë kryerjes së këtyre procedurave.

dh. Të organizojnë çdo formë tjetër të bashkëpunimit dhe shkëmbimeve në funksion të përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje.

#### **Neni 4 Komunikimi**

1. Rregulli i përgjithshëm i shkëmbimit të informacionit është ai shkresor ose elektronik.

2. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion, i cili do të jetë përgjegjës për zbatimin e saj, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

Për Agjencinë e Prokurimit Publik, person kontakti do të jenë Z. Amarildo Zëre, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Koncesioneve/PPP dhe Procedurave në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë, me këto kontakte:

Email: [amarildo.zere@app.gov.al](mailto:amarildo.zere@app.gov.al)

Për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, person kontakti do të jenë Z. Altin Jani, Përgjegjës i Sektorit Industrial, me kontaktet e mëposhtme:

Email: [altin.jani@nsa.gov.al](mailto:altin.jani@nsa.gov.al)

3. Palët angazhohen të jenë të disponueshme në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin me njëra-tjetrën, me qëllim rakordimin e veprimeve, që duhet të ndërmerren rast pas rasti.

Çdo mosmarrëveshje krijuar mbi interpretimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

#### **Neni 5 Administrimi i informacionit**

1. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët angazhohen të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër dhe kanë detyrimin e mosshpërndarjes së këtij informacioni tek personat e paautorizuar.

2. Informacioni i shkëmbyer në kuadër të kësaj marrëveshje ndërmjet palëve nënshkruese do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 6 Ndryshime**

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të palëve.

**Neni 7**  
**Përfundimi i Marrëveshjes**

1. Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 8**  
**Dispozita të fundit**


1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve.
2. Secila palë merr përsipër njohjen e strukturave të varësisë me përmbajtjen e kësaj marrëveshje, si dhe respektimin e zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
3. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Agjencinë e Prokurimit Publik dhe dy në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

Kjo marrëveshje u nënshkrua sot, në datë 27.07.2023

**Agjencia e Prokurimit Publik**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**REIDA KASHTA**



**Autoriteti Kombëtar për Sigurinë  
e Informacionit të Klasifikuar**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**DORIAN TOGA**

